



REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 629/25 Dt. 03.12.2025



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), të nenit 2, 3 dhe 8 të Rregullores për Transportin Rrugor në Komunën e Prizrenit nr. 001/011-171537 datë 01 dhjetor 2022, dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Shërbimeve Publike, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M Për formimin e Komisionit

- Formohet dhe emërohet Komisioni për vlerësimin e ofertave për rregullimin e transportit linjor urban-periferik në relacionin Vërmicë-Zhur-Vërmicë. Anëtarë të këtij Komisioni emërohen:
 - 1.1. Zekë Tejeci,.....kryesues,
 - 1.2. Asim Kokaj,anëtar,
 - 1.3. Alban Krasniqi,.....anëtar.
- Detyrat e Komisionit janë: vlerësimi i ofertave për rregullimin e transportit linjor urban-periferik, konform shpalljes publike nr. ref. 05-343-/141806, datë 23.10.2025, në relacionin Vërmicë-Zhur-Vërmicë, të Rregullores për Transportin Rrugor në Komunën e Prizrenit nr. 001/011-171537, datë 01 dhjetor 2022 dhe aktet të tjera ligjore dhe nënligjore që e rregullojnë këtë lëmi.
- Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës në Shërbimin Civil, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi.
- Obligohet Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Komisioni për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Shërbimeve Publike,
 - Komisionit,
 - Arkivës së Kryetarit.

